

KOSOVË

INFRASTRUKTURA PËR UJËRA TË ZEZA NË FERIZAJ



Plani për Angazhim të Palëve të Interesit (PAPI)

Tetor 2023

Shënim: Ky dokument është një përkthim i origjinalit të shkruar në anglisht. Në rast të ndonjë paqartësie apo dyshimi, versioni në gjuhën angleze ka përparësi.

Lista e akronimeve dhe shkurtesave

BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
MS	Mjedisor dhe Social
PMS	Politika Mjedisore dhe Sociale (e BERZH-it)
KBTRMJ	Korniza për Blerje të Tokës dhe Rimëkëmbje të Mjeteve të Jetesës
PBTRMJ	Plani për Blerje të Tokës dhe Rimëkëmbje të Mjeteve të Jetesës
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
NJZP	Njësia e Zbatimit të Projektit
KP	Kërkesat e Performancës (të BERZH-it)
KRUB	Kompania Rajonale e Ujësullës Bifurkacioni
PAPI	Plani për Angazhim të Palëve të Interesit
ITUZ	Impiant për Trajtim të Ujërave të Zeza

1	HYRJE	4
1.1	Përshkrim i Shkurtër i Projektit.....	4
1.2	Objektivat dhe fushëveprimi i këtij Plani për Angazhim të Palëve të Interesit	5
2	KËRKESAT RREGULLATORE PËR ANGAZHIMIN E PALËVE TË INTERESIT	6
2.1	Kërkesat e legjislationit lokal	6
2.2	Kërkesat e BERZH-it.....	7
3	PROGRAMI PËR ANGAZHIM TË PALËVE TË INTERESIT	8
3.1	Hyrje.....	8
3.2	Përgjegjësia për zbatimin e PAPI-t.....	8
3.3	Palët e interesit të projektit.....	8
3.4	Angazhimi i mëparshëm i palëve të interesit.....	10
3.5	Shpalosja e informacionit dhe konsultimet e planifikuara.....	11
3.6	Objektivat dhe Metodat e Angazhimit.....	13
4	MENAXHIMI I ANKESAVE	17
5	MONITORIMI DHE RAPORTIMI	20
6	SHTOJCA	21
	Shtojca 1: Formulari për Ankesa i Projektit	21
	Shtojca 2: Regjistri i ankesave – Shabllon	22
	Shtojca 3: Regjistri i Brendshëm i Angazhimit të Palëve të Interesit – Shabllon	22

1 HYRJE

1.1 Përshkrim i Shkurtër i Projektit

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) po shqyrton ofrimin e financimit për Qeverinë e Kosovës për të financuar modernizimin dhe rindërtimin e infrastrukturës për trajtim të ujërave të zeza dhe të kanalizimeve në Ferizaj. Infrastruktura e ujit dhe ujërave të zeza në Ferizaj operohet dhe menaxhohet nga subjekti publik Kompania Rajonale e Ujësjellësit Bifurkacioni (KRUB), e cila i ofron shërbimet e veta brenda kufijve administrativë të tri komunave: Ferizaj, Kaçanik dhe Hani i Elezit.

Megjithatë, nuk ka një impiant për trajtimin e ujërave të zeza (ITUZ), dhe një pjesë e konsiderueshme e seksioneve të vjetra të rrjetit të ujërave të zeza është në gjendje të pariparuar, duke përjetuar shpesh bllokime të gypave për shkak të akumulimit të sedimentit. Mangësitë në rrjetet ekzistuese të ujërave të zeza dhe mungesa e shërbimeve të trajtimit të ujërave të zeza kanë rezultuar në ndotje të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Prandaj, ekziston nevoja urgjente për modernizimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së ujërave të zeza, çka do të përmirësonte cilësinë e shërbimeve të ujërave të zeza, si dhe cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Projekti kategorizohet “B”¹ në përputhje me Politikën Mjedisore dhe Sociale të vitit 2019 (PMS)².

Projekti do të menaxhohet nga një Njësi e Zbatimit të Projektit (NJZP) që përbëhet nga përfaqësues të KRUB-së dhe qeverisë qendrore (ministritë relevante).

Në vitin 2014, si kontribut në procesin e para-anëtarësimit të Kosovës, BE-ja financoi një Studim Fizibiliteti për të vlerësuar kërkesat për trajtimin e ujërave të zeza për Ferizajn. Në vitin 2023, BERZH-i lansoi një përditësim të Studimit të Fizibilitetit nga konsulentë të pavarur, së bashku me një vlerësim Mjedisor dhe Social (MS) të projektit.

Bazuar në Studimin e Fizibilitetit të përditësuar, Projekti do të mbulojë:

1. **ndërtimin e ITUZ-it** (kapaciteti prej 90,000 ekuivalent i popullsisë) për t’u shërbyer qendrës urbane të Ferizajt dhe fshatrave të lidhura me të, si dhe tri fshatrave në komunën fqinje të Kaçanikut (Koxhaj, Elezaj, Bajnicë), si dhe **ndërtimin e një rruge hyrëse për në ITUZ** (rruga duhet ende të përcaktohet),
2. **zgjerimin e kolektorit kryesor ekzistues** nga lokacioni aktual afër fshatit Gërlicë deri në lokacionin e propozuar të ITUZ-it (rreth 3 km), dhe
3. **ndërtimin e një pjese të vogël të rrjetit të ri të ujërave të zeza** që kërkohet për të lidhur kolektorin kryesor me fshatrat Varosh, Grackë, Rakaj, Gërlicë dhe Doganaj (gjithsej më pak se 2 km), si dhe tri fshatra të komunës së Kaçanikut (Koxhaj, Elezaj, Bajnicë) (gjatësia nuk dihet për momentin).

Përfitimet e projektit përfshijnë:

- Projekti do të grumbullojë dhe trajtojë ujërat e zeza nga përafërsisht 75% e popullsisë në Komunën e Ferizajt.
- Të gjitha shkarkimet e ujërave të zeza në zonën mbledhëse Jug do të kapeshin dhe largoheshin nga lumi Nerodime, menjëherë në rrjedhën e sipërme të Komunës së Kaçanikut ngjitur.
- Kjo do të ketë një përmirësim të konsiderueshëm në cilësinë e ujit të lumit Nerodime, i cili është ndërkufitar me Maqedoninë e Veriut si dhe me Greqinë, duke kontribuar kështu në Direktivën Kornizë të BE-së për Ujërat. ITUZ-i do të trajtojë përafërsisht 5000 kg/ditë mbetje organike.
- Sistemi kolektor përfshin kapacitet për zgjerim në të ardhmen dhe përfshin rrjedhat nga tri fshatra të komunës së Kaçanikut.
- Projekti është në përputhje me politikat zhvillimore për ujëra të zeza të komunës.

¹Një projekt kategorizohet “B” kur ndikimet e tij të mundshme mjedisore dhe/ose sociale janë zakonisht specifike për lokacionin dhe/ose identifikohen dhe adresohen lehtësisht përmes masave efektive zbutëse.

² PMS e BERZH-it është e disponueshme në: <https://www.ebrd.com/news/publications/policies/environmental-and-social-policy-esp.html>

Lokacioni i propozuar për ITUZ-in është planifikuar të vendoset në tokë të rrafshët bujqësore, që gjendet në Komunën e Kaçanikut, në jug të fshatit Gërlicë. Sipërfaqja prej 8.1 hektarësh është aktualisht e klasifikuar si tokë bujqësore dhe në pronësi private. Kjo tokë do të duhet të blihet përgjithmonë për qëllimet e Projektit (sipas vlerësimeve fillestare, gjithsej 33 parcela toke në pronësi private do të preken nga blerja e përhershme e tokës). Procesi i blerjes së tokës është i detajuar në Kornizën për Blerje të Tokës dhe Rimëkëmbje të Mjeteve të Jetesës dhe do të zbatohet përpara ndërtimit. Bazuar në Kornizë, do të zhvillohet një Plan i detajuar për Blerjen e Tokës dhe Rimëkëmbjen e Mjeteve të Jetesës në konsultim me personat e prekur për të menaxhuar procesin e risistemimit pasi të bëhet e njohur natyra dhe qëllimi i saktë i blerjes së tokës.




Figura 1-1: Lokacioni i planifikuar i ITUZ-it

1.2 Objektivat dhe fushëveprimi i këtij Plani për Angazhim të Palëve të Interesit

Ky Plan për Angazhim të Palëve të Interesit (PAPI) është zhvilluar nga NJZP-ja në mënyrë që të gjitha palëve të interesit dhe të prekura t’u komunikohet qartë programi për angazhim të palëve të interesit që do të zbatohet gjatë gjithë ciklit të projektit.

Objektivi i këtij PAPI është të lehtësohet vendimmarrja në lidhje me projektin dhe të krijohen mundësi për përfshirjen aktive të të gjitha palëve të interesit në kohën e duhur, dhe të ofrohen mundësi për palët e interesit që të shprehin mendimet dhe shqetësimet e tyre që mund të ndikojnë në vendimet e projektit. Prandaj, qëllimi i PAPI-t është të rritet angazhimi i palëve të interesit gjatë gjithë ciklit jetësor të Projektit, si dhe që angazhimi i palëve të interesit të kryhet në përputhje me legjislacionin e Kosovës, si dhe me kërkesat e BERZH-it.

Ky PAPI është një dokument i gjallë që do të përditësohet periodikisht nga NJZP-ja sipas nevojës për të pasqyruar ndryshimet kyçe në aktivitetet e projektit ose çdo zhvillim të ri në fushëveprimin e projektit.

2 KËRKESAT RREGULLATORE PËR ANGAZHIMIN E PALËVE TË INTERESIT

2.1 Kërkesat e legjislacionit lokal

Ligjet e Kosovës që rregullojnë shpалosjen e informacionit dhe konsultimet publike dhe që janë relevante për këtë Projekt janë:

1. *Kushtetuta e Republikës së Kosovës* përcakton se dokumentet e autoriteteve shtetërore duhet të jenë të qasshme për publikun, me përjashtime të bëra për privatësi, fshehtësi tregtare apo arsye sigurie. Veç kësaj, ajo thekson përgjegjësinë kolektive për mjedisin, duke siguruar që opinionet publike të dëgjohen dhe të merren parasysh kur merren vendime që ndikojnë në mjedis.
2. *Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike* garanton të drejtën e çdo personi për të pasur qasje në dokumente publike. Institucionet publike janë të detyruara të publikojnë në mënyrë proaktive çdo dokument publik të prodhuar, marrë, mbajtur ose kontrolluar në formë elektronike, nëpërmjet publikimit në ueb faqet zyrtare të institucioneve publike, pavarësisht nga kërkesa e një personi për qasje. Publikimi bëhet në formë elektronike, të shtypur, transmetim ose në çfarëdo forme tjetër që mundëson qasjen e një numri më të madh të publikut.
3. *Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit* parasheh obligimin e institucioneve qendrore dhe lokale dhe të gjitha organizatave të tjera të autorizuar që ta informojnë publikun rregullisht, në kohën e duhur dhe objektivisht.
4. *Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor* përmban dispozita për pjesëmarrjen e detyrueshme të publikut dhe shqyrtimin publik gjatë miratimit të planeve hapësinore. Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2014 përmban udhëzime të mëtutjeshme për parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikimin hapësinor.
5. *Ligji Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme* përfshin dispozitat për procedurën e komunikimit dhe informimit gjatë blerjes së tokës (për shembull, autoriteti shpronësues kërkohet të dërgojë të gjitha dokumentet dhe informacionin e nevojshëm të bartësit e identifikuar të së drejtës pronësore dhe të mbajë seanca publike për shpronësimin në secilën komunë ku ndodhet prona e prekur; vendimi për shpronësim botohet në Gazetën Zyrtare dhe në gazetatat ditore, pasuar nga një periudhë 10-ditore gjatë së cilës palët e interesit mund t'i dorëzojnë komentet e tyre me shkrim për autoritetin shpronësues, etj.)
6. *Ligji Nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve* rregullon përdorimin e gjuhëve zyrtare, si dhe të gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare në institucionet e Kosovës dhe organizatat dhe ndërmarrjet e tjera publike. I jep status të barabartë shqipes dhe serbishtes si gjuhë zyrtare të Kosovës dhe të drejta të barabarta në përdorimin e tyre në të gjitha institucionet. Të gjitha komunitetet kanë të drejtë të ruajnë, mbajnë dhe promovojnë identitetin e tyre gjuhësor.
7. *Ligji Nr. 03/L-215 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale* përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit. Ky ligj përcakton përgjegjësitë e institucionit përgjegjës për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave dhe qasjes në dokumentet publike.

Legjislacioni tjetër relevant që siguron konsultim të duhur dhe trajtim të barabartë para ligjit do të përfshinte Ligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi; Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore; dhe Ligjin Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë.

2.2 Kërkesat e BERZH-it

Në PMS 2019, BERZH-i ka përcaktuar një grup gjithëpërfshirës të Kërkesave specifike të Performancës (KP) që projektet pritet të përmbushin. KP 10 (Shpalosja e informacionit dhe angazhimi i palëve të interesit) thekson rëndësinë e angazhimit të hapur, kuptimplotë dhe transparent me palët e interesit.

Kërkesat e KP 10 të BERZH-it mund të përmbliidhen si më poshtë:

- Procesi i angazhimit të palëve të interesit përfshin **identifikimin dhe analizën e palëve të interesit**, planifikimin e angazhimit, shpalosjen e informacionit, konsultim kuptimplotë, zbatimin e një mekanizmi për ankesa dhe raportimin e vazhdueshëm tek palët relevante të interesit. Angazhimi duhet të fillojë sa më shpejt që të jetë e mundur në zhvillimin e projektit dhe të vazhdojë gjatë gjithë ciklit jetësor të projektit.
- Klientët duhet të sigurojnë që palët e interesit të kenë **qasje në informacionin në kohë, relevant dhe të kuptueshëm**, dhe që angazhimi të kryhet në një mënyrë të përshtatshme dhe gjithëpërfshirëse nga ana kulturore, pa manipulime dhe detyrime. Klienti do të shpalosë informacionin relevant të projektit, në gjuhën(t) lokale dhe në një mënyrë që është e qasshme dhe e përshtatshme nga ana kulturore, duke marrë parasysh çdo nevojë specifike të grupeve që mund të ndikohen në mënyrë të ndryshme ose disproporcionale nga projekti ose të grupeve të popullatës me nevoja specifike për informacion të përshtatshëm. Gjatë gjithë jetës së projektit, klienti do të vazhdojë t'u ofrojë informacion palëve të interesit të identifikuar në mënyrë të vazhdueshme.
- Klienti do të ndërmarrë **konsultime kuptimplota**, bazuar në natyrën dhe shkallën e risqeve dhe ndikimeve negative të projektit dhe nivelin e interesit të palëve të interesit.
- Për t'iu përgjigjur në kohën e duhur shqetësimeve të palëve të interesit në lidhje me projektin, klienti do të krijojë një **mekanizëm efektiv për ankesa** sa më shpejt që të jetë e mundur në procesin e zhvillimit të projektit, për të marrë dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit.
- Klientëve u kërkohet të **zhvillojnë dhe zbatojnë një PAPI** që përshkruan si do të kryhet angazhimi, duke përfshirë kohën dhe metodat e angazhimit, informacionin që do të shpaloset, gjuhën(t) e shpalosjes dhe llojin e informacionit që duhet kërkuar nga palët e interesit. Klienti do të identifikojë palët e prekura nga projekti, të cilat, për shkak të rrethanave të tyre të veçanta, mund të jenë të pafavorizuara ose të cenueshme.

3 PROGRAMI PËR ANGAZHIM TË PALËVE TË INTERESIT

3.1 Hyrje

Në këtë PAPI, kanalet e komunikimit dhe informacionit janë dizajnuar duke marrë parasysh nevojat specifike të grupeve të ndryshme të palëve të interesit. **NJZP-ja pranon rëndësinë e angazhimit kuptimplotë dhe në kohë me palët e interesit për të siguruar suksesin e Projektit.** Nëpërmjet këtij procesi angazhimi, NJZP-ja synon të mbledhë reagime, komente dhe sugjerime të vlefshme nga palët e interesit për të përmirësuar dizajnin e Projektit dhe për të maksimizuar përfitimet lokale.

3.2 Përgjegjësia për zbatimin e PAPI-t

NJZP-ja është përgjegjëse për zbatimin e projektit. Një person specifik do të caktohet nga NJZP-ja për të qenë përgjegjës për zbatimin e këtij PAPI (informacioni i kontaktit jepet në Kapitullin 4 të këtij PAPI).

Kontraktorëve të ngarkuar për kryerjen e aktiviteteve specifike të Projektit do t'u kërkohej gjithashtu të zbatojnë dispozitat përkatëse të këtij PAPI (shih Kapitullin 4 për më shumë detaje). Kërkesat e mekanizmit për ankesa do të përcaktohen në kontratat që do të nënshkruhen me kontraktorët.

3.3 Palët e interesit të projektit

Janë identifikuar palët e interesit të projektit për të adresuar kërkesat e ndryshme të konsultimit. Palët e interesit përfshijnë persona ose grupe që:

- ndikohen drejtpërdrejt dhe/ose indirekt nga Projekti;
- kanë interesa të caktuara në Projekt dhe aktivitetet e tij; ose
- kanë aftësinë për të ndikuar në vetë Projektin dhe në rezultatin përfundimtar të tij.

Hartëzimi i palëve të interesit u krye gjatë zhvillimit të këtij PAPI bazuar në:

- vizita në terren në zonën e Projektit
- diskutime me zyrtarë të Komunës së Ferizajt (Drejtoria Urbanizmit dhe Drejtoria e Kadastrës)
- diskutime me zyrtarët e Komunës së Kaçanikut (Kryetari i Komunës, Zyra Kadastrale, Zyra për Urbanizëm dhe Zyra e Shërbimeve Publike)
- shqyrtimi i dokumentacionit të disponueshëm të projektit dhe kërkimi në media

Palët kyçe të identifikuar të projektit janë renditur më poshtë, ndërsa interesat/shqetësimet e tyre specifike dhe metodat e planifikuara të komunikimit janë të detajuara në seksionin 3.6. *Duhet të theksohet se çdo palë e interesit që nuk është identifikuar në këtë fazë të projektit mund të kontaktojë drejtpërdrejt me NJZP-në për të prezantuar veten dhe nevojat e veta, si dhe për të lehtësuar zbatimin efektiv të PAPI-t.*

1) Pronarët e tokës që preken nga blerja e tokës

Informatat e sakta për fushëveprimin e saktë të blerjes së tokës do të jenë në dispozicion vetëm pas zhvillimit të studimit të shpronësimit siç kërkohej me Ligjin e Kosovës për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme. Sipas vlerësimeve fillestare, gjithsej 33 parcela toke në pronësi private (që mbulojnë gjithsej 8.1 ha) do të preken nga blerja e përhershme e tokës. Në bazë të dokumentacionit të ofruar nga Zyra Kadastrale e Komunës së Kaçanikut, është konstatuar se nga numri i përgjithshëm i pronarëve të tokave, 7 i përkasin grupit etnik serb, ndërsa pronarët e mbetur janë pjesëtarë të shumicës kombëtare (shqiptare). Grupe të tjera specifike të cënueshme do të identifikohen në Planin për Blerje të Tokës dhe Rimëkëmbje të Mjeteve të Jetesës që do të zhvillohet. Nuk pritet asnjë zhvendosje fizike pasi që nuk ka struktura në tokën që do të blihet.

Nuk parashikohet që blerja shtesë e tokës të jetë e nevojshme për zgjerimin e kolektorit kryesor për shkak të vendosjes së tij të planifikuar përgjatë linjës ekzistuese hekurudhore.

Aktualisht, mbetet e paqartë nëse do të nevojitet blerja e tokës për ndërtimin e rrugës(ve) që shpjen në lokacionin e ITUZ-it. Gjithashtu, në fazat e ardhshme të dizajnit do të përcaktohet edhe traseja e saktë e pjesës së rjetit të ri të ujërave të zeza për lidhjen e kolektorit kryesor me fshatrat Varosh, Grackë, Rakaj, Gërlicë dhe Doganaj, Koxhaj, Elezaj dhe Bajnicë, por pritet që tubacionet e reja do të vendosen përgjatë rrugëve lokale, kështu që nuk do të jetë e nevojshme blerja e tokës private. Fazat e dizajnit të detajuar në të ardhmen e afërt do të ofrojnë qartësi për këto aspekte.

Në varësi të kërkesave logjistike të fazave të ardhshme të ndërtimit, mund të ketë okupim të përkohshëm të zonave të caktuara. Kjo mund të jetë për arsye të tilla si krijimi i kampeve të ndërtimit, përcaktimi i zonave të vendosjes së materialeve, ruajtja e dherave të sipërme, trajtimi i materialeve të gërmuara dhe aktivitete të tjera që lidhen me ndërtimin. Specifikat e këtyre kërkesave do të përcaktohen nga kontraktori i përzgjedhur.

2) Komunitetet lokale në Ferizaj dhe Kaçanik që mund të preken nga punimet ndërtimore

Shtëpitë dhe bizneset në afërsi të zonave të ndërtimit pritet të ndikohen përkohësisht nga aktivitetet e ndërtimit (në lidhje me ndërtimin e ITUZ-it dhe rrugën hyrëse; dhe zgjerimin e kolektorit kryesor ekzistues; dhe pjesë të rjetit të ri të ujërave të zeza që kërkohen për të lidhur kolektorin kryesor me fshatrat Varosh, Grackë, Rakaj, Gërlicë, Doganaj, Koxhaj, Elezaj dhe Bajnicë). Ndikimet dhe shqetësimet e përkohshme mund të përfshijnë zhurmën, pluhurin, ndikimet vizuale dhe kufizimet e trafikut gjatë fazës së ndërtimit.

3) Bashkësitë lokale në Kaçanik që mund të preken nga operimi dhe mirëmbajtja

Në afërsi të ITUZ-it të planifikuar janë vetëm disa shtëpi (më e afërta e vendosur rreth 300-400 metra larg nga ITUZ-i) dhe dy fabrika private më të vogla. Një shqetësim i rëndësishëm për komunitetin lokal gjatë fazës së funksionimit mund të jenë erërat e mundshme të lëshuara në mjedisin përreth për shkak të proceseve të trajtimit të ujërave të zeza dhe trajtimit të llumit në ITUZ.

Nga ana tjetër, operimi dhe mirëmbajtja e ITUZ-it do të kërkojë punë të kualifikuar dhe të pakualifikuar. Banorët do të jenë të interesuar për mundësitë e punës që mund të shfaqen. Përmirësimi i infrastrukturës lokale (rruga hyrëse që të çon në ITUZ) do të jetë gjithashtu një përfitim i perceptuar për komunitetin lokal.

4) Konsumatorët aktualë dhe të ardhshëm të KRUB, të cilët do të shërbehen nga ITUZ-i

Ky grup i palëve të interesit i referohet përfituesve të sistemit të përmirësuar të ujërave të zeza, d.m.th. konsumatorët rezidencialë, komercialë dhe institucionalë në qendrën urbane të Ferizajt dhe fshatrat e ndërlidhura (Varosh, Grackë, Rakaj, Gërlicë dhe Doganaj), si dhe tri fshatra në komunën ngjitur të Kaçanikut (Koxhaj, Elezaj dhe Bajnicë). Ata do të jenë përdoruesit e drejtpërdrejtë të infrastrukturës së përmirësuar të ujërave të zeza.

Interesat e tyre kryesore janë cilësia dhe besueshmëria e shërbimeve të ujërave të zeza, tarifat e shërbimit, qëndrueshmëria në ofrimin e shërbimeve, si dhe qëndrueshmëria afatgjatë dhe përfitimet mjedisore.

5) Palët e interesit me interes të përgjithshëm në projektet e ujërave të zeza

Kjo kategori përfshin një spektër më të gjerë individësh dhe organizatash që, megjithëse nuk preken drejtpërdrejt nga Projekti, mund të kenë interes në rezultatet e tij. Këtu përfshihen:

- Mediat: Mediat lokale dhe kombëtare luajnë një rol kyç në shpërndarjen e informacionit rreth Projektit, në formësimin e opinionit publik dhe në mbajtjen e personave të informuar për përditësimet e Projektit, përfitimet dhe çdo shqetësim të mundshëm.
- Popullata e përgjithshme e rajonit ose e vendit: Popullata e gjerë, ndonëse nuk shërbehet drejtpërdrejt nga sistemi i ujërave të zeza të Ferizajt, pritet të interesohet për përfitimet e Projektit përmes përmirësimit të cilësisë së ujit të lumit Nerodime dhe ndikimeve të tjera pozitive mjedisore.

- OJQ-të mjedisore: OJQ-të, veçanërisht ato me fokus në qëndrueshmërinë mjedisore dhe cilësinë e ujit të lumit Nerodime, do të jenë vëzhgues të zellshëm të Projektit. Shqetësimet e tyre parësore ka gjasa të jetë gjurma mjedisore të Projektit, përafri i tij me standardet ndërkombëtare (veçanërisht Direktivën Kornizë të BE-së për Ujërat) dhe potenciali i tij për të krijuar një precedent për projektet e ardhshme të infrastrukturës. *Shënim: Edhe pse organizata të tilla nuk kanë demonstruar ende interes specifik për këtë projekt, të gjithëve do t'u ofrohen mundësitë për të shprehur opinionet ose shqetësimet e tyre gjatë përgatitjes dhe zbatimit të projektit. Çdo organizatë e interesuar në projekt mund të dërgojë detajet e tyre të kontaktit në NJZP për t'u përfshirë në këtë PAPI dhe për t'u njoftuar drejtpërdrejt për ngjarjet e Projektit.*

6) Autoritetet relevante qeveritare

Ky grup përfshin organet rregullatore me mbikëqyrje dhe interes të caktuar në përfundimin dhe funksionimin me sukses të Projektit:

- Komunat e Ferizajt dhe Kaçanikut
- Autoriteti Rregullativ i Shërbimeve të Ujit (rregullon aktivitetet e ofruesve të shërbimeve të ujit në Kosovë dhe siguron ofrimin e shërbimeve cilësore, efikase dhe të sigurt; përcakton tarifat e shërbimeve; vendos standardet e shërbimeve; dhe monitoron performancën e ofruesve të shërbimeve)
- Këshilli Ndërmintor për Ujërat (organi koordinues dhe vendimmarrës përgjegjës për përmirësimin e sektorit të ujërave dhe mbrojtjen e burimeve ujore dhe sistemit ujor të Kosovës)
- Komisioni Ndërmintor për Ndërmarrjet Publike (përfaqëson Qeverinë në ushtrimin e të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës në Ndërmarrjet Publike si KRUB)
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - MMPHI (përgjegjëse për planifikimin hapësinor, blerjen e tokës, përcaktimin e kushteve për ndërtim, mbrojtjen e mjedisit)
- Ministria e Ekonomisë (aksionar në emër të Qeverisë së Kosovës, operon me Njësinë e Politikave dhe Monitorimit të Ndërmarrjeve Publike)
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (huamarrësi i fondeve për Projektin)
- INFRAKOS (përgjegjëse për menaxhimin e infrastrukturës hekurudhore në Kosovë)³
- Kompania Kosovare e Furnizimit me Energji Elektrike - KESCO (jep aprovimet për furnizim me energji elektrike)⁴

7) Kontraktorët ose nënkontraktorët për ndërtimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e punimeve dhe të punësuarit e tyre

Kontraktorët ose inxhinieri mbikëqyrës nuk janë përzgjedhur ende, por janë një palë kyçe e interesit për ekzekutimin dhe dorëzimin e suksesshëm të Projektit, duke garantuar sigurinë dhe pajtueshmërinë gjatë procesit të ndërtimit.

3.4 Angazhimi i mëparshëm i palëve të interesit

Deri më sot, ka pasur shpalosje të kufizuar të informacionit në lidhje me Projektin. Komuna e Kaçanikut, më 30 qershor 2016, ka miratuar një vendim me interes publik, i cili është vënë në dispozicion të publikut përmes ueb faqes së Komunës. Ndërveprimet e mëparshme me palët e interesit kufizoheshin kryesisht në diskutime ndërmjet KRUB dhe autoriteteve relevante qeveritare. Nuk janë bërë ende përpjekje për angazhim me komunitetin lokal dhe nuk janë mbajtur ende dëgjesa publike apo takime për të diskutuar për Projektin.

Komuna e Kaçanikut është në proces të shpalljes së një Plani të ri Zhvillimor Komunal që e përfshin lokacionin e propozuar të ITUZ-it. *Ligji për Planifikim Hapësinor* kërkon konsultime publike për të gjitha

³ Një nga opsionet për rrugën hyrëse në lokacionin e ITUZ-it kërkon kalimin e linjës hekurudhore që kalon pranë lokacionit, prandaj kërkohet miratimi nga INFRAKOS, megjithëse rrugët alternative janë të mundshme. Gjithashtu, kolektori kryesor do të zgjatet deri në lokacionin e ITUZ-it; megjithatë, itinerari është ngjitur me linjën hekurudhore, prandaj kërkon miratim nga INFRAKOS.

⁴Furnizimi me energji elektrike nga KESCO nuk arrin deri në lokacionin e ITUZ-it, prandaj kërkohet aprovimi për ta zgjatuar linjën e furnizimit me energji elektrike deri në lokacion.

dokumentet e planifikimit hapësinor. Aktualisht, draft plani është në shqyrtim nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Pas përfundimit të këtij shqyrtimi, plani do të publikohet për shqyrtim publik, pasuar nga organizimi i dëgjësave publike gjatë të cilave palët e interesit do të jenë në gjendje të ndajnë pikëpamjet dhe shqetësimet e tyre rreth planit të propozuar. Data, ora dhe vendi i sesioneve publike do të shpallen publikisht paraprakisht. Pas procesit të konsultimit, në dispozicion të publikut do të vihet një raport që përmbledh komentet e publikut dhe përgjigjet ndaj komenteve.

3.5 Shpalesja e informacionit dhe konsultimet e planifikuara

Angazhimi efektiv i palëve të interesit mbështetet në shpalesje transparente të informacionit dhe konsultime kuptimplota. Kjo pjesë detajon strategjinë e NJZP-së dhe aktivitetet e planifikuara për t'i mbajtur të informuara dhe të përfshira të gjithë palët e interesit gjatë gjithë ciklit jetësor të Projektit.

A. SHPALOSJA E DOKUMENTEVE TË PROJEKTIT

NJZP-ja do të shpalesë dokumentet e mëposhtme sa më shpejt që të jetë e mundur në procesin e zhvillimit të Projektit:

- këtë PAPI;
- Formulari për Ankesa i Projektit ([Shtojca 1](#) e këtij PAPI);
- Korniza për Blerje të Tokës dhe Rimëkëmbje të Mjeteve të Jetesës; dhe
- Përmbledhja Jo-teknike (PJT) e Projektit.

Dokumentet do të jenë të disponueshme publikisht në shqip, serbisht dhe anglisht **në formë elektronike dhe të shtypur në:**

Emri i institucionit	Ueb faqja	Adresa
KRUB	http://www.bifurkacioni.com/	Rr. Enver Topalli, Ferizaj, Kosovë Tel. +383 (0)290 320 650 info@bifurkacioni.com
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)	https://mmpHI.rks-gov.net/	Ish "Rilindja", 10000 Prishtinë, Prishtinë, Kosovë Tel. +383 (0) 38 200 32 003 dkp.mmpHI@rks-gov.net
Komuna e Ferizajt	https://kk.rks-gov.net/ferizaj/	Rr. Dëshmorët e Kombit, p.n., Ferizaj, Kosovë Tel. +383 (0)38 200 46 076 & 080011005 info.ferizaj@rks-gov.net
Komuna e Kaçanikut	https://kk.rks-gov.net/kacanik/	Rr. Emin Duraku, Kaçanik, Kosovë Tel. +383 290 380 047 & 080011014

B. TAKIME PËR KONSULTIM PUBLIK

NJZP-ja do të caktojë dhe mbajë **takimet e mëposhtme për konsultim publik** si më poshtë:

- të paktën një grup të takimeve pas përzgjedhjes së dizajnerit të projektit dhe fillimit të zhvillimit të Dizajnit Kryesor - për t'ua prezantuar Projektin palëve të interesit me qëllim të marrjes së reaguesve nga palët lokale të interesit,
- të paktën një grup të takimeve përpara fillimit të ndërtimit – për t'ua paraqitur detajet e projektit të përcaktuara në Dizajnin Kryesor të gjitha palëve të interesit dhe për të marrë reagues nga palët lokale të interesit.

Këto takime do të mbahen sa më afër që të jetë e mundur me lokacionet e projektit për të marrë parasysh nevojat e amvisërive, siç janë qytetarët dhe familjet me të hyra të ulëta ose personat e moshuar, mundësitë e udhëtimit të të cilëve mund të jenë të kufizuara. Gjithashtu, takimet do të organizohen duke marrë parasysh kohën që plotëson nevojat e punëtorëve të bujqësisë dhe grave. Sipas nevojës, NJZP-ja do të organizojë diskutime të ndara në grupe të vogla me çdo grup të cenueshëm ose përfaqësues të tyre, dhe do të identifikojë nëse mund të nevojitet ndonjë ndihmë e

mëtejshme specifike për të siguruar që grupe ose individë të tillë të mos përjashtohen ose të mos jenë në gjendje të marrin pjesë plotësisht në procesin e konsultimit.

NJZP-ja do t'i informojë 10 ditë përpara **të gjitha palët e interesit për datën, orën dhe vendin e saktë ku do të mbahen takimet**, përmes kanaleve të mëposhtme.

- Ueb faqet zyrtare të KRUB, MMPHI dhe Komunave të Ferizajt dhe Kaçanikut
- Njoftime të vendosura në vende të dukshme pranë lokacioneve të Projektit; ndërtesat e komunave të Ferizajt dhe Kaçanikut; si dhe zyrat e bashkësisë lokale në fshatrat Gërllicë, Varosh, Grackë, Rakaj, Doganaj, Koxhaj, Elezaj dhe Bajnicë.
- Mediat dhe gazetetat lokale me qarkullim të gjerë në Ferizaj dhe Kaçanik
- Rrjetet sociale

Të gjitha komentet dhe propozimet e lidhura me Projektin do të shqyrtohen nga NJZP-ja. Një **raport i shkurtër (“matrica e komenteve”)** për komentet/propozimet e pranuar dhe përgjigjet nga NJZP-ja do të publikohet në ueb faqet e KRUB, MMPHI, Komunës së Ferizajt dhe Komunës së Kaçanikut.

Të gjitha takimet do të mbahen në gjuhën shqipe, serbe, ose gjuhë të tjera në përdorim sipas nevojës.

Mund të ketë nevojë të mbahen takime të veçanta për t'iu përgjigjur nevojave të grupeve të ndryshme etnike si ashkali dhe romë⁵.

Në lidhje me procesin e blerjes së tokës do të zbatohet një proces gjithëpërfshirës konsultimi, siç përshkruhet në KBTRMJ.

C. INFORMIMI I PUBLIKUT PËR PUNIME TË NDËRTIMIT

NJZP-ja do të angazhohet për të ofruar informacion të qartë në lidhje me aspekte të ndryshme të aktiviteteve të planifikuara të ndërtimit. Kjo përfshin **specifikat në lidhje me lokacionet, datën e parashikuar të fillimit, kohëzgjatjen e pritshme të punimeve të planifikuara dhe çdo ndërprerje të parashikuar në flukset e trafikut dhe çdo shqetësim tjetër të mundshëm** për publikun, të paktën 30 ditë përpara fillimit të punimeve, përmes kanaleve të mëposhtme:

- Ueb faqet zyrtare të KRUB, komunave të Ferizajt dhe Kaçanikut
- Njoftime të vendosura në vende të dukshme pranë lokacionit të projektit, ambiente publike, duke përfshirë ambientet ekzistuese të ZBO-ve
- Mediat dhe gazetetat lokale me qarkullim të gjerë në Ferizaj dhe Kaçanik

Pasi të fillojë ndërtimi, **nga kontraktori do të vendosen tabela informacioni në vendpunishten(et) e ndërtimit** për të shfaqur qartë informacionin e kontaktit për shqetësimet e palëve të treta (të dhënat e kontaktit të personit të dedikuar të kontaktit të caktuar për të adresuar çdo çështje ose shqetësim të ngritur nga palët e treta - emrin, pozitën, numrin e telefonit dhe adresën e emailit).

D. INFORMIMI I PUBLIKUT GJATË GJITHË OPERIMIT DHE MIRËMBAJTJES

Rezultatet e procesit të angazhimit të palëve të interesit do të përfshihen ne Raportet Mjedisore dhe Sociale për BERZH-in që do të përgatiten nga NJZP-ja, duke përmbledhur ndikimet mjedisore dhe sociale, performancën e shëndetit dhe sigurisë, performancën e shpalosjes dhe konsultimit, si dhe zbatimin e mekanizmit të jashtëm për ankesa. **Një përmbledhje e këtyre Raporteve Mjedisore dhe Sociale do të përgatitet nga NJZP-ja çdo vit për të siguruar raportim të rregullt tek palët e interesit, dhe do të postohet online** (pa asnjë informacion konfidencial) në ueb faqen e KRUB.

Për më tepër, gjatë fazës së operimit dhe mirëmbajtjes, KRUB do të angazhohet për të adresuar çdo **shqetësim nga kutërbimi** si çështje esenciale për ruajtjen e marrëdhënieve të mira me komunitetin

⁵ Në komunën e Ferizajt, shqiptarët përbëjnë grupin më të madh etnik me rreth 95%, të ndjekur nga ashkali dhe romë, ndërsa në Kaçanik pothuajse 100% e banorëve janë shqiptarë.

përreth. Për t'i menaxhuar efektivisht këto shqetësime, KRUB do t'i përcjellë rregullisht ankesat përmes mekanizmit për ankesa të projektit, dhe në rast ankesash nga banorët lokalë në lidhje me aromat e pakëndshme, të vlerësojë mundësinë e instalimit të sistemeve efektive të kontrollit të aromave në pika kyçe në ITUZ ku ka gjasa të emetohen gazra me erë, të tillë si filtra të karbonit të aktivizuar, biofiltra ose pastrues kimikë. Njëkohësisht, në tabelën informative të ITUZ-it që përmban informata esenciale në lidhje me impiantin, KRUB do të përfshijë informacionin e kontaktit për ankesa publike.

3.6 Objektivat dhe Metodatat e Angazhimit

Lista e palëve të interesit të identifikuar dhe kërkesat specifike të komunikimit jepen në tabelën e mëposhtme.

Siç u theksua më parë, kjo listë e palëve të interesit më poshtë mund të mos jetë përfundimtare dhe çdo palë e interesit që nuk është identifikuar në këtë fazë të projektit mund të kontaktojë drejtpërdrejt me NJZP-në për të prezantuar veten dhe nevojat e veta. PAPI do të përditësohet nga NJZP-ja në përputhje me rrethanat. Sugjerimet për përmirësimin e metodave të propozuara të komunikimit janë gjithashtu të mirëseardhura dhe mund t'i dërgohen NJZP-së, e cila është e hapur për reagime nga palët e interesit.

Tabela 3-1: Programi për Angazhim të *Palëve të Interesit*

Palë interesi e identifikuar	Çështje apo interesa specifike	Aktivitetet dhe përpjekjet e komunikimit dhe angazhimit	Informata/dokumentet që duhen shpalosur
<p>Pronarët e tokës që preken nga blerja e tokës</p>	<p>Blerja e tokës private, kufizimet e përdorimit të tokës dhe qasjes në asete dhe burime natyrore</p>	<p><i>Gjatë zhvillimit dhe zbatimit të PBTRMJ-së (në fazën para ndërtimit):</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Sigurimi i informacionit në kohë për aktivitetet e blerjes së tokës dhe përgjigjeve ndaj pyetjeve/ankesave • Zhvillimi i Planit të ardhshëm për Blerje të Tokës dhe Rimëkëmbje të Mjeteve të Jetesës (PBTRMJ) bazuar në konsultimet dhe angazhimin e targetuar të nivelit të amvisërive (intervista të amvisërive, diskutime në grupe të fokusit, intervista me informuesit kyç) • Prezantimi i Kornizës për Blerje të Tokës dhe Rimëkëmbje të Mjeteve të Jetesës (KBTRMJ) dhe PBTRMJ-së së ardhshëm, dhe diskutimi i çështjeve dhe shqetësimeve rreth blerjes së tokës • PBTRMJ do të përfshijë konsiderata të veçanta për nevojat e grupit etnik pakicë dhe të personave të zhvendosur për të siguruar ndarjen e duhur dhe në kohë të informacionit. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përdorimit adekuat të gjuhëve zyrtare gjatë shpalosjes së informacionit relevant. • Në lidhje me pronarët që mungojnë të pronave, veçanërisht grupi etnik pakicë dhe personat e zhvendosur, do të përdoren të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të identifikuar dhe gjetur në mënyrë të duhur pronarët që mungojnë të pronave, për të angazhuar ndihmën e zyrave të komuniteteve të pakicave dhe/ose organizatave joqeveritare në Kosovë nëse është e nevojshme, dhe për të depozituar shumën e kompensimit në një llogari të veçantë në Bankën Qendrore të Kosovës. 	<ul style="list-style-type: none"> • Informacione për procesin e blerjes së tokës (fillimi i procesit, vendimi për interesin publik, plani hapësinor komunal, e kështu me radhë) • Informacion për mekanizmin e disponueshëm për ankesa (si procedurat për ankesa sipas Ligjit të Kosovës për Shpronësimin ashtu edhe mekanizmi për ankesa specifik për projektin i krijuar në këtë PAPI) • Përgjigjet ndaj pyetjeve/ankesave • Përmajtja e KBTRMJ dhe PBTRMJ të ardhshëm

<p>Komunitetet lokale në Ferizaj dhe Kaçanik që mund të preken nga punimet ndërtimore</p>	<p>Aktivitetet e ndërtimit që mund të shkaktojnë shqetësime për popullatën lokale (zhurmë, pluhur, dridhje, kufizime të qasjes, rritje të trafikut)</p>	<p><i>Para fillimit të punimeve të ndërtimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Qasja në dokumentet e Projektit online dhe në ambientet e KRUB, Komunitat e Ferizajt dhe Kaçanikut • Takime publike dhe sigurimi i qasjes në matricën e komenteve pas takimeve • Shpalsja e informacionit për punimet e planifikuara të ndërtimit 30 ditë para fillimit të punimeve • Mekanizmi për ankesa i projektit vendoset në vendpunishtet e ndërtimit dhe mbahet i disponueshëm gjatë gjithë procesit të ndërtimit 	<ul style="list-style-type: none"> • Paketa e shpalsjes të projektit (PAPI, PJT, Formulari për Ankesa) • Matrica e komenteve (të përgatitet pas takimeve publike) • Informacion për shtrirjen, kohën dhe kohëzgjatjen e punimeve të planifikuara • Informacion për disponueshmërinë e mekanizmit për ankesa • Raporte të përmbledhura Mjedisore dhe Sociale (vjetore)
<p>Komunitetet lokale në Kaçanik që mund të ndikohen nga operimi dhe mirëmbajtja e ITUZ-it (disa shtëpi dhe biznese në afërsi të ITUZ-it të ardhshëm)</p>	<p>Kutërbimet e mundshme të lëshuara nga operimet e ITUZ-it</p> <p>Mundësitë e punësimit</p> <p>Përmirësimi i infrastrukturës lokale (rruga e re hyrëse)</p>	<p><i>Gjatë fazës së operimit dhe mirëmbajtjes:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Qasje në përmbledhjen e Raporteve Mjedisore dhe Sociale çdo vit • Tabelat informative në hyrje të ITUZ-it me kanalin për ankesa publike 	
<p>Konsumatorët aktualë dhe të ardhshëm të KRUB, të cilët do të shërbehen nga ITUZ-i (përfituesit e sistemit të përmirësuar të ujërave të zeza, d.m.th. konsumatorët rezidencialë, komercialë dhe institucionalë në qendrën urbane të Ferizajt dhe fshatrat shoqëruese (Varosh, Grackë, Rakaj, Gërlicë dhe Doganaj), si dhe tri fshatra në komunën fqinje të Kaçanikut (Koxhaj, Elezaj dhe Bajnicë)</p>	<p>Cilësia dhe besueshmëria e shërbimeve të ujërave të zeza, tarifat e shërbimit, qëndrueshmëria në ofrimin e shërbimeve, si dhe qëndrueshmëria afatgjatë dhe përfitimet mjedisore</p> <p>Rritja e cilësisë së ujit të lumit Nerodime</p>	<p><i>Gjatë fazës së operimit dhe mirëmbajtjes:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpalsja e informacionit përmes ueb faqes zyrtare të KRUB, faqes në Facebook, njoftimeve për media • Linja e informacionit pa pagesë e KRUB • Anketat vjetore të KRUB për kënaqshmërinë e klientëve dhe raportet e publikuara për anketat • Qasje në përmbledhjen e Raporteve Mjedisore dhe Sociale çdo vit 	<ul style="list-style-type: none"> • Informacion për përfitimet e ITUZ-it dhe çdo ndërprerje të mundshme; tarifat e shërbimit • Informacion për disponueshmërinë e mekanizmit për ankesa • Raporte të përmbledhura Mjedisore dhe Sociale (vjetore)
<p>Palët e interesit me interes të përgjithshëm në projektet e ujërave të zeza (media lokale dhe kombëtare, popullata e përgjithshme e rajonit ose e vendit, OJQ-të mjedisore që mund të shfaqin interes)</p>	<p>Suksesi i përgjithshëm i Projektit dhe përafrimi me standardet ndërkombëtare</p> <p>Rritja e cilësisë së ujit të lumit Nerodime dhe ndikime të tjera pozitive mjedisore</p>	<p><i>Para fillimit të ndërtimit dhe në vazhdimësi pas tij:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Publikime online të dokumenteve dhe informacioneve të projektit • Media lokale/deklarata për shtyp • Takime publike dhe sigurimi i qasjes në matricën e komenteve pas takimeve • Qasje në përmbledhjen e Raporteve Mjedisore dhe Sociale çdo vit 	<ul style="list-style-type: none"> • Dokumentet e projektit (PAPI, PJT, Formulari për Ankesa i Projektit) dhe matrica e komenteve • Informacion për shtrirjen, kohën dhe kohëzgjatjen e punimeve të planifikuara • Raporte të përmbledhura Mjedisore dhe Sociale (vjetore)
<p>Autoritetet relevante qeveritare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Komunitat e Ferizajt dhe Kaçanikut • Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit 	<p>Lëshimi i lejeve, pëlqimeve dhe opinionëve në përputhje me legjislacionin kombëtar;</p>	<p><i>Brenda afateve kohore dhe në shpeshësinë e kërkuara nga secili autoritet:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Kanalet zyrtare të komunikimit 	<ul style="list-style-type: none"> • Informacion për aktivitetet e projektit në formatet e kërkuara nga

<ul style="list-style-type: none"> • Këshilli Ndërmintor për Ujërat • Komisioni Ndërmintor për Ndërmarrjet Publike • Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës • Ministria e Ekonomisë • Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve • INFRAKOS • Kompania Kosovare e Furnizimit me Energji Elektrike - KESCO 	<p>monitorimi i pajtueshmërisë me legjislacionin e Kosovës</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Konsultime me autoritetet qeveritare në kuadër të procedurave për leje • Raportimi dhe monitorimi bazuar në kërkesat e legjislacionit kombëtar 	<p>legjislacioni kombëtar</p>
<p>Kontraktorët ose nënkontraktorët për ndërtimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e punimeve dhe të punësuarit e tyre</p>	<p>Shëndeti dhe siguria; kushtet e punësimit dhe të punës; kushtet dhe ndikimet mjedisore; siguria rrugore dhe e trafikut</p>	<p><i>Para fillimit të ndërtimit dhe gjatë gjithë procesit të ndërtimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Informacion përmes kontraktimit • Trajnime dhe aftësime para futjes në punë • Komunikim nëpërmjet inxhinierëve mbikëqyrës • Biseda në vendpunishtet e ndërtimit për tema të shëndetit dhe sigurisë, Procedurën për Gjetje të Rastit dhe tema të tjera • Raporte të rregullta për ecurinë e punimeve të realizuara gjatë punimeve të ndërtimit • Mekanizmi për ankesa të punëtorëve 	<ul style="list-style-type: none"> • Informacion për rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë, kërkesat për mbrojtjen e mjedisit • Informacion për mekanizmin për ankesa të punëtorëve

4 MENAXHIMI I ANKESAVE

Vështrim i përgjithshëm

NJZP-JA po përpiqet të sigurojë që ndërtimi i ITUZ-IT nuk do të rezultojë në ndikime negative për ata që jetojnë pranë lokacionit të Projektit ose për palët e tjera të interesit potencialisht të prekura. NJZP-JA e kupton se menaxhimi i ankesave është një komponent jetik i angazhimit të palëve të interesit dhe një aspekt i rëndësishëm i menaxhimit të riskut për Projektin. Në nivel të projektit është vendosur një mekanizëm për ankesa për komunitetet e prekura, për vlerësimin dhe adresimin e ankesave nga komunitetet e prekura. NJZP-ja do të zbatojë mekanizmin për ankesa për të siguruar që ai të përgjigjet ndaj çdo shqetësimi dhe ankese, veçanërisht nga palët e interesit dhe komunitetet e prekura.

Si NJZP-ja ashtu edhe kontraktorët/inxhinierët mbikëqyrës në terren do të pranojnë ankesat që lidhen me projektin. NJZP-ja do të monitorojë mënyrën si trajtohen ankesat dhe do të sigurojë që ato të adresohen siç duhet brenda afateve të specifikuar në mekanizmin e paraqitur më poshtë. Ky kapitull përfshin shtojcat e mëposhtme mbështetëse: Formulari për Ankesa i Projektit ([Shtojca 1](#)), shablloni i Regjistrimit të Ankesave ([Shtojca 2](#)) dhe shablloni i Regjistrimit të Angazhimit të Palëve të Interesit ([Shtojca 3](#)).

Pjesët vijuese të këtij kapitulli shtjellojnë procedurën dhe hapat për ankesa rreth projektit. Për punëtorët është i disponueshëm një mekanizëm i veçantë për ankesa.

Dorëzimi i ankesave

Çdo shqetësim mund të silltet në vëmendje të NJZP-së verbalisht (personalisht ose me telefon) ose me shkrim duke plotësuar formularin për ankesa të projektit (me dorëzim personal, postë ose e-mail në adresën/numrin e dhënë më poshtë), pa ndonjë kosto të shkaktuar ndaj ankuesit. Ankesat mund të dorëzohen gjithashtu në mënyrë anonime ose pa përdorimin e formularit nëse preferohet.

Pas fillimit të punimeve të ndërtimit, formulari për ankesa i projektit mund t'i dorëzohet gjithashtu drejtpërdrejt kontraktorit për punimet e ndërtimit ose inxhinierit mbikëqyrës, i cili do t'ia përcjellë çdo ankesë të tillë të marrë NJZP-së pa vonesë (brenda 24 orëve) për t'i lejuar NJZP-së ta përpunojë më tej ankesën/komentin (d.m.th. regjistrimi, pranimi dhe përgjigja ndaj ankesës në afatet kohore të përcaktuara më poshtë).

Tabelat informative që do të vendosen në vendpunishten e ndërtimit do të shfaqin qartë informacionin e kontaktit për shqetësimet e palëve të treta (të dhënat e kontaktit të personit të dedikuar të kontaktit të caktuar për të adresuar çdo çështje ose shqetësim të ngritur nga palët e treta - emrin, pozitën, numrin e telefonit dhe adresën e emailit).

Regjistrimi dhe pranimi i ankesave

NJZP-ja do t'i regjistrojë të gjitha ankesat në Regjistrin e Ankesave (formati i dhënë në [Shtojcën 2](#)), të ndarë nga Regjistri i Angazhimit të Palëve të Interesit ([Shtojca 3](#) e këtij PAPI), që detajon ndërveprimet me komunitetet dhe palët e interesit.

Të gjitha ankesat do të regjistrohen nga NJZP-ja në regjistër dhe secilës do t'i caktohet një numër. Ankesat me shkrim dhe jo anonime do të pranohen brenda 5 ditëve të punës. Për të mundësuar monitorimin dhe vlerësimin e duhur, çdo ankesë do të regjistrohet në regjistër me informacionin e mëposhtëm:

- përshkrimi i ankesës, duke përfshirë një tregues të llojit (temës) të ankesës – si ankesa në lidhje me dhunën dhe ngacmimin në baza gjinore, ankesa në lidhje me zhurmën ose pluhurin e ndërtimit, ankesa në lidhje me ruajtjen e pamjaftueshme të materialeve dhe pajisjeve të ndërtimit, etj. – për të mundësuar zbulimin në kohë të incidenteve më të shpeshta, konstatimin e tendencave dhe menaxhimin e risqeve,

- detaje rreth profilit të ankuesit (gjinia, mosha, lokacioni dhe cenueshmëritë nëse dihen), për të kuptuar se kush dhe ku ndikohet më shumë nga ndikimet potencialisht negative të Projektit – vini re: ky informacion do të konsiderohet konfidencial dhe do t'i shpaloset vetëm stafit të NJZP-së që punon me ankesat,
- datën e marrjes së ankesës dhe kur i është njoftuar pranimit ankuesit,
- përshkrimin e veprimeve të ndërmarra (hetim, masa korigjuuese, masa parandaluese), dhe
- datën e zgjidhjes dhe mbylljen/ofrimin e reagimeve për ankuesin, duke përfshirë regjistrimin e nivelit të kënaqshmërisë me zgjidhjen e propozuar (shih formularin për mbyllje të ankesave më poshtë).

Ndihma për ankuesit

Nëse ankesa është e turbullt dhe jo mjaftueshëm e qartë, NJZP-ja do të ndihmojë dhe do të ofrojë këshilla për formulimin/rihartimin e parashtrësës, në mënyrë që ankesa të bëhet më e qartë, për qëllime të një vendimi të informuar nga NJZP-ja, në interesin më të mirë të personave të prekur nga Projekti dhe duke marrë parasysh hapat e preferuar të zgjidhjes nga ankuesi.

Zgjidhja e ankesave

NJZP-ja do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për ta adresuar ankesën pas pranimit të ankesës. Nëse NJZP-ja nuk është në gjendje t'i adresojë çështjet e ngritura me veprime të menjëhershme korigjuuese, do të identifikohet një veprim korigjuues afatgjatë. **Ankuesi do të informohet për veprimin e propozuar korigjuues dhe vazhdimin e veprimit korigjuues brenda 10 ditëve të punës pas pranimit të ankesës.** Do të identifikohen dhe zbatohen veprime parandaluese me qëllim të parandalimit të përsëritjes së të njëjtës çështje në të ardhmen; këto do t'i komunikohen edhe ankuesit.

Gjatë procesit të informimit të ankuesit për veprimin e propozuar, NJZP-ja do të vërtetojë kënaqshmërinë e ankuesit duke ofruar një **formular për mbylljen e ankesës** për ankesën e zgjidhur, i cili do të nënshkruhet nga ankuesi (nëse ankuesi pajtohet) dhe NJZP-ja për të vërtetuar pajtimin e tyre të përbashkët. NJZP-ja do të bëjë përpjekje të arsyeshme për përcjellje me ankuesin për të verifikuar zbatimin e suksesshëm të veprimit.

Nëse NJZP-ja nuk është në gjendje të adresojë çështjen e caktuar të ngritur përmes mekanizmit për ankesa ose nëse nuk kërkohet veprim, ajo do të japë një shpjegim/arsyetim të detajuar pse nuk është adresuar çështja. Përgjigja do të përmbajë edhe një shpjegim se si mundet personi/organizata që ngriti ankesën të vazhdojë me ankesën në rast se rezultati nuk është i kënaqshëm.

Në çdo kohë, ankuesit mund të kërkojnë mjete të tjera juridike në përputhje me kornizën ligjore lokale, duke përfshirë ankesën zyrtare gjyqësore. Hakmarrja ndaj ankuesve është rreptësisht e ndaluar me ligj.

Informacione të kontaktit për dërgim të ankesave:

PROJEKTI PËR INFRASTRUKTURË TË UJËRAVE TË ZEZA NË FERIZAJ

Njësia e Zbatimit të Projektit

Rr. Enver Topalli, Ferizaj, Kosovë

Tel. +383 (0)290 320 650

E-mail: info@bifurkacioni.com

Mekanizmi i pavarur i BERZH-it për llogaridhënie të projektit

Përveç mekanizmit në nivel të projektit të menaxhuar nga NJZP-ja, Mekanizmi i pavarur i BERZH-it për llogaridhënie të projektit⁶ (IPAM), si një mjet i pavarur për mundësinë e fundit të zgjidhjes kur dështon mekanizmi i projektit, synon të lehtësojë zgjidhjen e çështjeve sociale, mjedisore dhe publike të ngritura

⁶ Informacion rreth procesit IPAM gjeni në: <https://www.ebrd.com/what-we-do/independent-project-accountability-mechanism.html>

nga personat e prekur nga Projekti dhe organizatat e shoqërisë civile në lidhje me projektet e financuara nga BERZH-i midis palëve të interesit të projektit ose të përcaktojë nëse Banka ka respektuar PMS-në e vet dhe dispozitat specifike për Projektin sipas Politikës së vet për Qasje në Informacion; dhe aty ku është e aplikueshme për të adresuar çdo mospërputhje ekzistuese me këto politika, duke parandaluar papajtueshmërinë e ardhshme nga ana e Bankës.

5 MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Rezultatet e procesit të angazhimit të palëve të interesit do të përfshihen ne **Raportet Mjedisore dhe Sociale për BERZH-in** që do të përgatiten nga NJZP-ja, duke përmbledhur ndikimet mjedisore dhe sociale, performancën e shëndetit dhe sigurisë, performancën e shpalosjes dhe konsultimit, si dhe zbatimin e mekanizmit të jashtëm për ankesa. Një **përmbledhje e këtyre Raporteve Mjedisore dhe Sociale** do të përgatitet nga NJZP-ja çdo vit për të siguruar raportim të rregullt tek palët e interesit, dhe do të **postohet online** (pa asnjë informacion konfidencial) në ueb faqen e KRUB.

Raportet do të përfshijnë, në veçanti, informacionin e mëposhtëm:

- **Numri dhe llojet (temat) e ankesave të pranura prej komunitetit** të ngritura në periudhën raportuese (p.sh. ankesat e lidhura me dhunën dhe ngacmimin në baza gjinore, ankesat e lidhura me zhurmën ose pluhurin e ndërtimit, ankesat e lidhura me ruajtjen e pamjaftueshme të materialeve dhe pajisjeve të ndërtimit, etj. – për të mundësuar zbulimin në kohë të incidenteve më të shpeshta), me tregues të ankesave të hapura, të zgjidhura dhe të mbyllura, dhe nëse ato janë mbyllur brenda afateve kohore të përcaktuara në mekanizmin për ankesa;
- **Numri dhe llojet e aktiviteteve për shpalosje të informacionit** përmes mediave dhe ueb faqeve zyrtare;
- **Vendi dhe koha e mbajtjes së takimeve konsultative dhe llojeve të tjera të aktiviteteve të angazhimit**, me informacion për numrin e pjesëmarrësve, çështjet dhe shqetësimet e ngritura gjatë takimeve, si dhe informata si janë marrë në konsideratë nga NJZP-ja çështjet e ngritura.

NJZP-ja do të jetë përgjegjëse për monitorimin e të gjitha aktiviteteve të angazhimit të palëve të interesit në lidhje me Projektin, duke siguruar përmbushjen dhe përditësimin e këtij PAPI dhe raportimin tek BERZH-i dhe publiku.

[Shtojca 3](#) e këtij PAPI ofron një shabllon për përcjelljen e aktiviteteve të angazhimit të palëve të interesit.

6 SHTOJCA

Shtojca 1: Formulari për Ankesa i Projektit

Numri i referencës	
Emri i plotë (opsionale)	
<ul style="list-style-type: none"> Dua ta paraqes ankesën time në mënyrë anonime. Kërkoj të mos e shpalosni identitetin tim pa pëlqimin tim. 	
Informata të kontaktit	Me Postë: Ju lutemi shënoni adresën e postës: _____ _____
Ju lutemi shënoni se si dëshironi të kontaktoheni (postë, telefon, email).	Me telefon: _____ Me email
Gjuha e preferuar e komunikimit	- Shqip - Serbisht - Anglisht (nëse është e mundur) - Tjetër _____
Përshkrimi i incidentit të ankesës	
Përshkrimi i incidentit të ankesës	Çka ndodhi? Ku ndodhi? Kujt i ndodhi? Cili është rezultati i problemit?
Data e Incidentit / Ankesës	
	<ul style="list-style-type: none"> Incident/ankesë për një episod (data _____) Ka ndodhur më shumë se një herë (sa herë? _____) Në vazhdim (duke përjetuar problem)
Çka do të dëshironit të shihnit të ndodhte?	

Nënshkrimi: _____

Data: _____

Ju lutemi që këtë formular t'ia dorëzoni:

Njësia e Zbatimit të Projektit
Rr. Enver Topalli, Ferizaj, Kosovë
Tel. +383 (0)290 320 650
E-mail: info@bifurkacioni.com

Shtojca 2: Regjistri i ankesave – Shabllon

Shënim: Çdo e dhënë personale do të përpunohet në përputhje me Ligjin e Kosovës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Nr. 03/L-215.

	Emri i ankuesit	Informata të kontaktit	Data e marrjes	Data e pranimit	Përshkrimi i ankesës	Zgjidhja e propozuar	Data e mbylljes	Formulari për mbyllje i nënshkruar (Po/Jo)	Përcjellja e ankesës	Përsëritje (Po/Jo)	Veprimi/shënime
1.	<i>Shëno emrin ose 'anonim'</i>										
2.											
3.											

Shtojca 3: Regjistri i Brendshëm i Angazhimit të Palëve të Interesit – Shabllon

Shënim: Çdo e dhënë personale do të përpunohet në përputhje me Ligjin e Kosovës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Nr. 03/L-215.

	Kategoria dhe emri i palës së interesit	Lloji i angazhimit	Data e angazhimit	Çështjet/shqetësimet kyçe	Veprimi përcjellës i dakorduar	Shënime për progresin
1.	<i>(P.sh., OJQ, banor i prekur, instituti i trashëgimisë kulturore...)</i>	<i>(P.sh., takim zyrtar, prezantim, takim joformal...)</i>				
2.						
3.						